

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA GLLOGOC**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **611-26-5285-5-2-1**

Sa i përket tenderit për **INSTALIMI I NXEMJEVE QENDRORE -RIPARIMI I KULMIT NE SHMU XHELADIN GASHI-PLAKU - KOMORAN-Ritenderim**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Treing SH.P.K.
NUI	812136522
Adresa	Rruga Dëshmorët e Ponoshecit, 69
Vendi	Prishtinë
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	049 293 969
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Uljan Thaçi
Adresa elektronike	3ingshpk@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	20.07.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

INSTALIMI I NXEMJEVE QENDRORE -RIPARIMI I KULMIT NE SHMU XHELADIN GASHI-PLAKU - KOMORAN-Ritenderim

Aktiviteti aktual është ritenderim i aktivitetit të mëparshëm me nr. 611-26-3060-5-2-1, me të njëjtin objekt kontrate. Për aktivitetin e parë, OE Treing SH.P.K. kishte kontestuar kriteret për stafin profesional, stafin teknik/punëtorët dhe pajisjet/mekanizmin. Çështja ishte trajtuar nga OSHP në lëndën nr. 2026/0350.

Në Raportin e Ekspertit Shqyrtues/Teknik nr. 2026/0350 është konstatuar se projekti ka natyrë renovuese dhe riparuese në objekt ekzistues shkollor, jo ndërtim të ri, objekt industrial apo infrastrukturë të gjerë. Raporti ka identifikuar se disa kriteret - përfshirë muratorin e certifikuar, punëtorin e certifikuar për hidroizolim, kriteret hidro, frezën e montuar në ekskavator dhe kontejnerët - nuk rezultojnë qartë të domosdoshme nga paramasa në formën e kërkuar dhe duhej të rishqyrtoheshin që të ishin të qarta, të matshme, të lidhura drejtpërdrejt me objektin dhe proporcionale.

Me Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0350 është lënë në fuqi anulimi i aktivitetit të vjetër dhe është përcaktuar se, nëse AK e ritenderon aktivitetin, duhet të veprojë në përputhje me dispozitat ligjore dhe rekomandimin e ekspertit shqyrtues.

Pavarësisht kësaj, në dosjen e ritenderimit të publikuar më 01.07.2026, AK ka përsëritur ose riformuluar një pjesë të madhe të kriterëve të kontestuar. Për këtë arsye, OE ka dorëzuar Kërkesën për Rishqyrtim më 07.07.2026.

Me Vendimin e datës 10.07.2026, AK e ka aprovuar kërkesën vetëm pjesërisht: ka larguar kërkesën për ekspert të menaxhimit të emergjencave/mbrojtjes nga zjarri, ka ulur përvojën e Inxhinierit të Elektroteknikës nga 7 në 5 vite, ka larguar Inxhinierin e Gjeodezisë, ka larguar vetëm certifikimin si auditor i energjisë eficiente nga kriteri hidroteknik dhe ka larguar gjeneratorin 300 kVA. Të gjitha kërkesat e tjera për stafin teknik dhe pajisjet janë mbajtur me arsyetime të përgjithshme.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Vendimi i AK date:10.07.2026

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Nenet 1 dhe 6 të LPP-së - economiciteti, efikasiteti, transparenca dhe përdorimi racional i parasë publike;
- Neni 7 i LPP-së - trajtimi i barabartë, mosdiskriminimi dhe konkurrenca e hapur;
- Neni 27 i LPP-së - hartimi i Dosjes së Tenderit në përputhje me kërkesat ligjore;
- Neni 69 i LPP-së - kërkesat minimale për aftësinë teknike dhe profesionale duhet të jenë relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës;
- Neni 108/A i LPP-së - detyrimi i AK-së për shqyrtim real, individual dhe të arsyetuar të kërkesës për rishqyrtim;
- Nenet 109, 111 dhe 112 të LPP-së - e drejta e ankesës, përmbajtja e saj dhe efekti pezullues;
- Neni 17 i Rregullores (A01) nr. 001/2024 për Prokurimin Publik - kriteret duhet të jenë të qarta, relevante dhe proporcionale;

Vendimi i OSHP-së nr. 2026/0350 dhe rekomandimet e Raportit të Ekspertit Shqyrtues/Teknik nr. 2026/0350

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendimi nr. 1 - Vendimi i AK-së është i paarsyetuar në pjesën refuzuese. AK nuk ka bërë analizë individuale të pretendimeve, por ka përdorur përfundime të përgjithshme. Për stafin teknik ka deklaruar se të gjitha kërkesat mbeten në fuqi sepse janë “vetëm certifikata të natyrës së punës së tyre”. Për pajisjet ka deklaruar se kërkesat e tjera mbeten sepse, sipas AK-së, janë në përputhje me natyrën e punës dhe nuk janë kufizuese, si dhe lejohet marrëveshja me qira. Këto fjali nuk tregojnë: cilin pozicion të paramasës e mbulon secili kriter; pse kërkohet pikërisht certifikimi ose pajisja e caktuar; pse pragu i përvojës është i domosdoshëm; dhe pse masa më pak kufizuese nuk mjafton. Ky nuk është shqyrtim efektiv sipas nenit 108/A, por refuzim formal pa arsyetim teknik të verifikueshëm.

Pretendimi nr. 2 - Ulja e përvojës së Inxhinierit të Elektroteknikës nga 7 në 5 vite është korrigjim kozmetik dhe arbitrar. Vetë AK pranon se punimet elektrike janë punime standarde përcjellëse të renovimit dhe instalime kryesisht të tensionit të ulët. Nuk ka nënstacione, tension të lartë ose instalime industriale. Megjithatë, AK nuk shpjegon pse kërkohen 5 vite dhe jo një përvojë tjetër proporcionale. Ndryshimi i numrit pa analizë të kompleksitetit nuk e shëron kriterin diskriminues; thjesht e zëvendëson një prag arbitrar me një prag tjetër arbitrar.

Pretendimi nr. 4 - Kërkesat për stafin teknik dhe punëtorët profesionalë janë mbajtur pa analizë të paramasës. Vendimi nuk trajton individualisht asnjë nga kundërshtimet e mëposhtme:

- Tekniku i Arkitekturës i certifikuar/licencuar - lloji i certifikimit, institucioni lëshues dhe lidhja me pozicionet e paramasës nuk janë përcaktuar qartë;
 - Muratori me diplomë ose certifikatë - paramasa përmban vetëm rreth 16 m² muratim standard, për të cilin raporti teknik ka vlerësuar se certifikimi specifik duket i tepruar;
 - Personi i certifikuar për hidroizolim - në paramasën e shqyrtuar nuk është identifikuar pozicioni i qartë për punime hidroizolimi;
 - Tekniku/instaluesi elektrik me certifikime të shumëfishta për energji, klimatizim, mjedis dhe mbrojtje nga zjarri - certifikimet shpesh nuk lidhen me punimet standarde elektrike të tensionit të ulët;
 - Specialisti i certifikuar për montim/saldim të tubave PE/HDPE - nuk është dhënë volum ose kompleksitet konkret që e bën këtë certifikim kusht eliminues;
 - Tekniku i Makinerisë i certifikuar për instalimin e tubave dhe sistemeve të ngrohjes qendrore - AK duhet të identifikojë pozicionet konkrete dhe vëllimin e punëve që e bëjnë këtë certifikim të domosdoshëm, jo të mbështetet vetëm në titullin e aktivitetit.
- Arsyetimi i AK-së se secili profesionist “e ka edhe certifikatën” është i gabuar.

Certifikatat nuk janë automatikisht të zakonshme ose të domosdoshme për çdo person që ushtron profesionin. Kur kërkohen si kushte eliminatorë, AK ka barrën të dëshmojë relevancën dhe proporcionalitetin e secilës prej tyre.

Pretendimi nr. 5 - Kërkesat për pajisjet dhe mekanizmin mbeten joproporcionale; lejimi i qirasë nuk e zgjidh problemin. AK ka larguar vetëm gjeneratorin 300 kVA, ndërsa ka mbajtur pajisjet e tjera me arsytim të përgjithshëm. Kontestimi nuk ka të bëjë vetëm me pronësinë e pajisjeve, por me nevojën e tyre teknike dhe me përdorimin e tyre si kushte eliminatorë. Konkretisht:

- Freza e montuar në ekskavator për hapje kanali është mbajtur edhe pse punimet e kanalizimit janë të kufizuara dhe nuk është evidentuar volum që e kërkon domosdoshmërisht këtë pajisje të specializuar;
- Kontejneri me sipërfaqe fikse 18 m² mbetet specifikim arbitrar. AK mund të kërkojë plan të sigurisë dhe organizimit të punishtes, por jo një format fiks pa analizë të numrit të punëtorëve, kohëzgjatjes dhe kushteve reale të objektit;
- Mini Bobcat me peshë maksimale 950 kg është kërkesë e re dhe tepër specifike, pa identifikim të pozicioneve që nuk mund të realizohen me mjete funksionalisht ekuivalente;
- Miniekskavatori, minidamperi, pompat, skelat dhe pajisjet e tjera duhet të kërkohen vetëm kur janë realisht të nevojshme dhe duhet të lejohen alternativa funksionale, jo modele, kapacitete ose karakteristika arbitrare.

Një marrëveshje me qira mund të dëshmojë qasje në pajisje, por nuk dëshmon se pajisja është e nevojshme, relevante ose proporcionale. Prandaj arsyetimi i AK-së nuk i përgjigjet pretendimit kryesor.

Pretendimi nr. 6 - AK nuk ka zbatuar në mënyrë substanciale Vendimin dhe Raportin nr. 2026/0350. OSHP kishte përcaktuar se, nëse aktiviteti ritenderohet, AK duhet të veprojë sipas dispozitave ligjore dhe rekomandimit të ekspertit. Raporti teknik kishte identifikuar shprehimisht muratorin e certifikuar, hidroizolimin, kriteret hidro, frezën dhe kontejnerët si kriterë që nuk rezultojnë qartë të domosdoshme dhe që duhej të rishqyrtoheshin. Në ritenderim, disa janë mbajtur, disa janë riformuluar dhe disa janë zëvendësuar me kërkesa të reja kufizuese. AK nuk ka paraqitur projekt, llogaritje, analizë teknike ose ndryshim të paramasës që do ta justifikonte devijimin nga gjetjet e ekspertit. Kjo është moszbatim substancial i vendimit të mëparshëm, jo korrigjim real i dosjes.

Pretendimi nr. 7 - Vendimi nuk siguron korrigjim të qartë të dosjes dhe afat real për ofertim. Pika II e vendimit e lejon AK-në të vazhdojë me njoftimin për kontratë “me të dhënat si në pikën I”, por nuk e identifikon versionin e korrigjuar të dosjes, nuk përcakton

mënyrën e publikimit të ndryshimeve dhe nuk urdhëron zgjatjen e afatit për ofertim. Vendimi është nxjerrë më 10.07.2026, ndërsa hapja ishte paraparë më 13.07.2026. Edhe korrigjimet që AK i ka pranuar nuk mund të zbatohen në mënyrë efektive pa publikim të qartë dhe pa afat të arsyeshëm për përgatitjen e ofertave. Kjo bie ndesh edhe me rekomandimin e ekspertit në lëndën 2026/0350 për përmirësim të dosjes dhe zgjatje të afatit.

Pretendimi nr. 8 - Efekti kumulativ i kriterëve kufizon konkurrencën dhe krijon favorizim objektiv. Edhe kur secili kriter shikohet veçmas, mungon arsyetimi i plotë. Kur ato shikohen së bashku - profile të shumta, licenca, certifikime të dyfishta dhe pajisje tepër specifike - krijohet një filtër artificial që zvogëlon numrin e operatorëve të aftë për të ofertuar. Kjo cenon konkurrencën e hapur dhe trajtimin e barabartë sipas nenit 7 të LPP-së, rrit kostot e ofertimit dhe rrezikon shpenzimin joefikas të parasë publike.

Duke u bazuar në faktet, provat dhe dispozitat e lartcekura, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që të nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. APROVOHET si e bazuar ankesa e OE Treing SH.P.K.;
2. ANULOHET ose ndryshohet Vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës 10.07.2026, në pjesën me të cilën janë refuzuar pretendimet e ankuesit;
3. DETYROHET Autoriteti Kontraktues që ta pezullojë çdo veprim të mëtejshëm në aktivitetin nr. 611-26-5285-5-2-1 dhe të respektojë efektin pezullues të ankesës

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Kriteret e kontestuara e pengojnë OE Treing SH.P.K. që të marrë pjesë në mënyrë efektive dhe të barabartë. Ato e detyrojnë ankuesin të sigurojë formalisht staf, certifikime dhe pajisje që nuk dalin nga nevojat reale të kontratës, duke krijuar shpenzime të panevojshme dhe rrezik të eliminimit. Dëmi përfshin shpenzimet e përgatitjes së ofertës dhe të procedurave të rishqyrtimit/ankimit, humbjen e mundësisë reale për konkurrim dhe fitimin e munguar nga kontrata.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.

- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-së, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.